





REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-1078/14</u>
Nr. I faq. Broj stranica <u>03</u>	Data Datum <u>20.03.2014</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	18.03.2014
REFERENC-Ë:	AKK-D.P.K.
PËR/ZA/TO:	z. Ahmet Shala – Koordinator në njësinë rajonale për patentë shofera - Pejë, (Ministria e Infrastrukturës)
Cc:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni –  Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion - Ofrimi i këshillimit profesional lidhur me Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik



I nderuari ztr. Shala

Lidhur me informacionin e pranuar në Agjencinë kundër Korrupsionit (DPK-03-527/14), ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I.), Agjencia; *"bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin rast për rast të interesave"*, (Neni 19, pika 1.5, e Ligjit Nr.04/L-051).

Lidhur me kërkesen tuaj, në pajtim me mandatin që kemi dhe duke u bazuar në Ligjet bazë të Agjencisë, për rastin e caktuar, kemi nxjerr këtë :

Faqe 1 nga 1

OPINION :

Ushtrimi i funksioneve publike si Koordinator në njësinë rajonale për patentë shofera - Pejë, dhe Anëtar i Kuvendit Komunal të Pejës, shprehimisht nuk është i ndaluar me Ligjin për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051).

Arsyetim:

Këtu do tu njoftojmë cilat situata konsiderohen konflikt interesi për zyrtarin dhe po ashtu, në bazë të kërkesës tuaj me numër protokoli të AKK-së DPKI-03-527/14, do të përgjigjemi në pyetjen që ju e keni parashtruar në shkresën tuaj të datës 07.02.2014.

Së pari është me rëndësi të citojmë nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, i cili përkufizon *çka është konflikti i interesit ?*.

Nga ky përkufizim kuptojmë, pos të tjerash, se; *“konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtëpërdrejta ose të tërrthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”*.


Po ashtu në Nenin 8 të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit janë të përcaktuara detyrimet e zyrtarit të lartë për të shmangur situatat e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Rasti i juaj konkret ka të bëjë më tepër me sqarimin e asaj që quhet papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, duke qenë se ju keni një funksion si Koordinator në njësinë rajonale për patentë shofera - Pejë, ndërkohë që jeni certifikuar edhe si Anëtar i Kuvendit Komunal të Pejës.

Meqense Ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit nuk parashihet kufizime të kësaj natyre e as nuk e ka të paraparë si papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, ne ju kemi referuar Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Konkretisht nenit 17 që flet për “Nëpunësit civilë të zgjedhur ose të emëruar në detyrë publike jashtë Shërbimit Civil”, dhe atë si vijon:

1. Nëpunësit civilë mund të mbajnë, përkohësisht, pozita politike. Gjatë mandatit të tyre në këto pozita, statusi i tyre i nëpunësit civil pezullohet për shkak të mospërputhshmërisë ndërmjet emërimit politik dhe statusit të nëpunësit civil.

2. Nëpunësit civil, të cilët janë kandidatë për zgjedhjet komunale dhe qendrore, vendosen në pushim të veçantë pa pagesë një (1) muaj para zhvillimit të zgjedhjeve deri në certifikimin zyrtar të



zgjedhjeve. Nëpunësi civil i cili nuk zgjidhet ka të drejtë të kthehet në vendin e tij/saj të punës në shërbimin civil një (1) javë nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.

3. Nëpunësit civil nuk mund të mbajnë pozita drejtuese në parti politike dhe të jenë aktiv politikisht.

4. Shërbyesit civil që janë të zgjedhur në zgjedhjet komunale dhe qendrore kanë të drejtë të aplikojnë dhe të konkurrojnë me kandidatë të tjerë për cilëndo pozitë të lirë në shërbimin civil.

Prandaj ju rekomandojmë që të veproni konform këtij Opinioni për të parandaluar dhe shmangur çdo situatë që mund të sjellë zyrtarin e lartë në gjendje të konfliktit të interesit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ndërkohë që Agjencia kundër Korrupsionit ka marr njoftimin zyrtar (DPKI-03-890/14) me listën e zyrtarëve të lartë të Komunës së Pejës, në të cilën shihet se ztr.Ahmet Shala ka dhënë dorëheqje nga funksioni si Anëtar i Asamblesë komunale në Pejë.

Me respekt,